



## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2010

#### **Kuvendi i Shqipërisë:**

- Duke mbështetur veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si një institucion i pavarur, i cili, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Duke vlerësuar impenjimin e Komisionerit në hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe në përmirësimin e performancës së Komisionerit në ushtrimin e funksioneve të tij ligjore mbikëqyrëse dhe monitoruese;
- Duke nxitur bashkëpunimin e Komisionerit me kontrolluesit publikë dhe privatë, të cilët përpunojnë të dhëna personale, me qëllim rritjen e garancive në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

#### **Konstaton se gjatë vitit 2010:**

- Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale është impenjuar në fushatën sensibilizuesendërgjegjësuere për njohjen me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe detyrimet ligjore që rrjedhin prej tij, si dhe në rritjen e bashkëpunimit me institucionet publike dhe private;
- Komisioneri i ka kushtuar rëndësi hartimit dhe miratimit të kuadrit nënligjor. Ka miratuar aktet nënligjore, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për administrimin dhe sigurimin e të dhënave personale, si dhe akte të tjera për mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit. Ka përgatitur projektregulloren tip “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”;
- Me qëllim lehtësimin e njohjes me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri ka përgatitur dhe botuar komentarin e parë të ligjit. Janë publikuar dhe shpërndarë edhe materiale të tjera ndërgjegjësuere, si broshura, fletëpalosje etj.
- Komisioneri ka përgatitur amendimet për ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të cilat janë në fazën e diskutimeve nga ekspertë të fushës;
- Komisioneri ka rritur performancën e punës së tij në të gjitha komponentët, në procesin e regjistrimit, trajtimit të ankesave, hetimit dhe inspektimit të kontrolluesve që përpunojnë të dhëna personale dhe ka përgatitur strategjinë e punës për vitin 2011, duke përcaktuar përparësitë dhe objektivat që duhet të realizohen në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- Me gjithë punën e kryer nga Komisioneri për parandalimin e shkeljeve të ligjit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, nga kontrollues të ndryshëm dhe, në veçanti, nga media vizive dhe e shkruar, rezultatet nuk kanë qenë në nivelin që pritej;
- Nuk është finalizuar puna e bërë për zbatimin e ligjit, në lidhje me vendosjen dhe vjeljen e sanksioneve administrative;
- Nuk është bërë identifikimi i plotë i të gjithë kontrolluesve dhe përpunuesve privatë dhe publikë që operojnë në Shqipëri.

**Kërkon për vitin 2011:**

- Intensifikim të punës për identifikimin e të gjitha subjekteve kontrolluese dhe përpunuese, publike dhe private, në Shqipëri dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e subjekteve kontrolluese;
- Rritje të angazhimit për dhënien e opinioneve ligjore për projektligjet që harton ekzekutivi dhe gjatë shqyrtimit të tyre në komisionet parlamentare, që kanë lidhje me fushën në të cilën ushtron veprimtarinë ky institucion;
- Ndjekje e zbatimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave personale, të nxjerra nga zyra e Komisionerit për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;
- Ndjekje të politikave inspektuese dhe kontrolluese për të verifikuar zbatimin e kushteve dhe kritereve ligjore për përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave personale;
- Monitorim në vazhdimësi të veprimtarisë së kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave personale, duke synuar evidentimin e drejtpërdrejtë të rasteve që cenojnë të dhënat personale të individit, si dhe ndërhyrjen e menjëhershme të Komisionerit për dhënien e rekomandimeve dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre;
- Rishikim të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për të pasqyruar përvojën dhe problemet që ka nxjerrë zbatimi i ligjit në praktikë, si dhe për përafrimin e tij me zhvillimet më të fundit të legjislacionit të Bashkimit Europian;
- Programim të punës kontrolluese të Komisionerit mbi bazë afatesh të përcaktuara dhe respektimin rigoroz të këtyre afateve, në shërbim të rritjes së efikasitetit dhe zbatueshmërisë së ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

7 korrik 2011

KRYETARE

**Jozefina Topalli (Çoba)**

*Fletore Zyrtare Nr.97 /datë 22.07.2011/fq.3949.*